



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2561, datë 27.04.2015

“Për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit “Vodafone Albania” sh.a. për një të drejte përdorimi në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.M.Drushku, në mbledhjen e datës 27.04.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit “Vodafone Albania” sh.a. për një të drejte përdorimi në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX”.

BAZA LIGJORE:

1. Ligji Nr 8485 datë 12.05.1999, “Kodi i procedurave administrative”;
2. Shkronja g, e nenit 8, nenet 62 deri 79 të ligjit 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918 i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në republikën e Shqipërisë”);
3. Vendimi Nr.466, datë 27.2.2013 “Per miratimin e Planit Kombetar te Frekuencave”.

4. Vendimi Nr. 1252, date 10.9.2008, te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e rregullave te zhvillimit te tenderit publik, per dhenien e se drejtes se perdorimit te frekuencave" i ndryshuar,
5. Rregullore per Autorizimin Individual, miratuar me Vendimin e Keshillit Drejtues te AKEP Nr. 2395 datë. 15.12.2013.
6. Vendimi i Keshillit Drejtues Nr.2548, datë 20.03.2015 për "Miratimin e Raportit Përmbledhës të KVO dhe Njoftimin e fituesve të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX", Ref. 6-2x6-2015.
7. Vendimi i Keshillit Drejtues nr.2551, datë 10.04.2015 për "Miratimin e Njoftimit të fituesit të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX", Ref. 6-2X6-2015"
8. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Keshillit Drejtues të AKEP.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Kopje e Faturave te pagesave të kryera nga sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a.
 - Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);
 - si dhe,
- duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar.

V Ë R E N :

1. Këshilli Drejtues i AKEP, me Vendimin nr.2551, datë 10.04.2015 për "Miratimin e Njoftimit të fituesit të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX", Ref. 6-2X6-2015" miratoi Njoftimin e Fituesit, sipas Shtojca 16 - Formulari i Njoftimit të Fituesit.
2. AKEP, bashkëlidhur shkresës Nr.825/3.Prot., datë 14.04.2015 i ka dërguar "Vodafone Albania" sh.a., Formularin e Njoftimit të Fituesit, Nr.825/2.Prot., datë 14.04.2015, sipas Shtojca 16, të përfshirë në dokumentacionin e tenderit.
3. "Vodafone Albania" sh.a. brenda afatit 7 (shtatë) ditë, nga data marrjes së Formularit të njoftimit të fituesit, njoftoi kryerjen e pagesave, të mëposhtëme:
 - a) Çmimin e ofertës me shumën **1.805.102 (nje milion e teteqind e pesemije e njeqind e dy) euro Euro**, më datë 20.04.2015, në Llogarinë bankare me emërtim: *Qeveria Shqiptare*.

- b) Pagesa për 8 muaj **336,000 (treqind e tridhjetë e gjashtë mijë) lekë** për përdorimin e spektrit 2x2.4 MHz të frekuencave të brezit 1800 MHz më datë 20.04.2015.
- c) Pagesa për 8 muaj **752,640 (shtatëqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë** për tarifën e shërbimit për shërbimet e radiokomunikimit, për përdorimin e spektrit 2x2.4 MHz të frekuencave të brezit 1800 MHz më datë 20.04.2015.

Pagesa sipas pika a) të mësipërme, është kryer në Bankën e Shqipërisë, *Qeveria Shqiptare* në EUR me Nr: AL89 1011 1008 0000 0000 2111 001E .

Pagesat sipas pika b) dhe c) të mësipërme, janë kryer në llogarinë bankare të AKEP, me Nr: AL30214112090 111113869030117.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në sa më sipër, në kompetencat që i janë dhënë nga:

1. Ligji Nr.8485 dt 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”;
2. Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, për ”Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, gërma g, neni 8, nenet 62 deri 79, neni 114 dhe neni 115 ,
3. VKM Nr.466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”,
4. Vendimet e Këshillit të Ministrave Nr.1252, datë 10.9.2008, i ndryshuar,
5. Rregullorja për Autorizimin Individual, miratuar me VKD Nr. 2395 datë. 15.12.2013.
6. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

V E N D O S :

1. Të pajisë sipërmarrësin “Vodafone Albania” sh.a .me Autorizim Individual për një të drejte përdorimi 2x2.4 MHz në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Sipërmarrësi do të shfytëzojë frekuencat e dhëna nëpërmjet procedurës së tenderit publik me objekt “*Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX*”, Ref. 6-2x6-2015, në përputhje me kushtet e pranuar të Dokumentit të Tenderit.
3. Afati i vlefshmërisë së Autorizimit Individual për të drejten e përdorimit 2x2.4 MHz të fituar nëpërmjet tenderit me objekt “*Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX*”, Ref. 6-2x6-2015 do të jetë 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, nga 01.04.2015 deri në 01.04.2030.

4. Vendosja në spektër, brezi 1800 MHz, dhe fillimi i shfrytezimit të këtij spektri në përputhje me kushtet e vendosura në Autorizimin Individual bashkëlidhur këtij vendimi do të njoftohen me një vendim tjetër të AKEP.

5. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Anila DENAJ** _____
3. **Ketrin TOPÇIU** _____
4. **Klarina ALLUSHI** _____